



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 47/2021

Nr. Protokolli: 67/2021

Për:	Seticommerc SH.P.K., Shiroke-Suharek, 23000 SHIROKË
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	14.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 11.05.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: Seticommerc SH.P.K., Shiroke-Suharek, 23000, SHIROKË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtim i rrugëve Sadri Shasha, Sadik Sejda, Haki Sokoli, Ali R. Bytyqi, Minatori, Jemin Jemini, Bajram Kurti në Mushtishtë” me Nr. të Prokurimi: 624-21-555-5-2-1 & 624-021-023-521-nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 11.05.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik:: "Seticommerc SH.P.K., Shiroke-Suharek, 23000 SHIROKË" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtim i rrugëve Sadri Shasha, Sadik Sejda, Haki Sokoli, Ali R. Bytyqi, Minatori, Jemin Jemini, Bajram Kurti në Mushtishtë kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 07.05.2021 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 07.05.2021.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **11.05.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Ndërtim i rrugëve Sadri Shasha, Sadik Sejda, Haki Sokoli, Ali R. Bytyqi, Minatori, Jemin Jemini, Bajram Kurti në Mushtishtë** me Nr. të Prokurimit: **624-21-555-5-2-1 & 624-021-023-521** -, kundër Njoftim per Vendimin e AK -së, të datës **07.05.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se pretendimet tuaja nuk qendroj, ngase ne oferten tuaj **pas kërkeses për sqarim në disa pozicione nga anëtarët e komisionit, deshmit e pranuar nuk janë bindese per AK, dokumente te cilat janë përdor në cdo aktivitet të Prokurimit të Komunes së Suharekës. Andaj dhe të njejtat dëshmi keni perdor edhe në aktivitetet me te cilin ju pretendoni 624-21-478-5-2-1 & 624-021-009-521, ku dallimi është shumë i madh, ngase te ky aktivitet ka më pak sasi dhe se rrugët janë të projektuar të ndërtohen me kubza betoni dhe për Ak- Suharekë është fakt i njohur se ju jeni Prodhues i kubzave të betonit, andaj kemi marrë për bazë këtë fakt.**

**Ndërsa të njejtat dëshmi nuk janë bindës për AK- mbase ne disa aktivitete keni sjellur dëshmi të njejtat.**

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

